



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi i Kosovës/Skupstina Kosova/Assembly of Kosovo
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
Regulatorna Komisija Javne Nabavke
Public Procurement Regulatory Commission



RAPORTI MBI AKTIVITETET E PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË PËR VITIN 2014

01 janar 2014 - 31 dhjetor 2014

**Shkurt 2015
Prishtinë**

P Ë R M B A J T J A

1. Përmbledhje ekzekutive
2. Korniza Ligjore
3. Përshkrimi i Institucionit (Organizmi institucional)
4. Fushëveprimi që e mbulon institucioni
5. Aktiviteti për periudhën raportuese
6. Pjesa e fundit e raportit - rekomandimet/sfidat e institucionit (rritja e stafit, ndryshimi i ligjit)
7. Raportimi rreth adresimit të rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm
8. Raporti financiar
9. Shtojcat

FJALA E KRYETARIT TË KRPP-së

Të nderuar deputet të Parlamentit të Kosovës,

Kam knaqësinë t'ju dorëzoj Raportin Vjetor mbi aktivitetet e prokurimit publik në Republikën e Kosovës për periudhën Janar-Dhjetor 2014.

Ky raport paraqet në mënyrë analitike të dhënat për kontratat publike, ndarjen e tyre mbi bazën e llojit të procedurave të përdorura nga autoritetet kontraktuese, nivelin e përdorimit të këtyre procedurave, nivelin e konkurrencës brenda tregut publik, si dhe shumë indikator tjerë të rëndësishëm për matjen e performancës së prokurimit publik në Kosovë.

Në raport gjithashtu do të gjeni edhe informacione kualitative për aktivitetet e KRPP-së në planin e monitorimit të sistemit të prokurimit publik, duke përfshirë të gjeturat dhe rekomandimet tona në funksion të përmirësimit të këtij sistemi në përgjithësi.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik vazhdon të kryej me përkushtim maksimal dhe përgjegjësi misionin e saj, duke ofruar bazën ligjore solide në mbështetje të shpenzimit në mënyrë të duhur të parasë publike, si dhe asistencën e nevojshme ligjore për autoritetet kontraktuese, operatorët ekonomik, organet e rendit duke përfshirë dhe gjykatat, si dhe shoqërinë civile dhe mediat si partner strategjik të KRPP-së.

Kemi punuar ngushtë me Qeverinë dhe Kuvendin për të zgjeruar kapacitetet tona punuese në dhënjën e informacioneve të duhura mbi shfrytëzimin e parasë publike. Gjithashtu kemi pasur bashkëpunim të ngushtë edhe me Qeverinë dhe aktorët tjerë vendor dhe ndërkombëtar në ndërtimin e një sistemi më të mirë të prokurimit në përgjithësi.

Me zhvillimin dhe përmirësimin e këtij sistemi, një hapsirë të konsiderueshme zënë edhe përkrahja dhe mbështetja që n'a është dhënë nga SIGMA, ZNKE, Banka Botërore etj, për të përmirësuar kornizën ligjore e cila është duke u zbatuar edhe më shumë, dhe kjo rezulton me mbikëqyrje më të fortë.

Në bashkëpunim me BB kemi arritë që këtë vit të fillojmë me ndërtimin e platformes elektronike të prokurimit publik (e-prokurimi), gjithashtu kemi arritur që të ngrisim indexin e çmimeve për artikujt që gjejnë zbatim të gjerë në blerjet publike, si dhe kemi filluar për herë të parë me monitorimin e pajtueshmërisë së performancës në prokurim publik.

Për një mbikëqyrje më të suksesshme kërkohet angazhim dhe përkrahje, si dhe harmonizim të aktiviteteve edhe me akterë tjerë ndër-institucional si Zyra e Auditorit të Përgjithëshëm, Agjensioni Antikorrupsion, NjKE pranë Policisë së Kosovës, Prokurorin, Gjykatat, si

dhe akterë të shoqërisë civile, OJQ, dhe media, si dhe një bashkëpunim dhe përkrahje nga nivelet më të larta.

Qasjet dhe metodat e reja si dhe shembujt e suksesit që KRPP-ja ka sjellur këto vite duhet të jenë vizion yni në mënyrë që të përmbushim me shumë suksesë misionin tonë të përcaktuar me Ligjin për Prokurim Publik. Në raste të kundërta duhet të merren ndërveprime me vendosmëri të palëkundurë në realizimin e këtij misioni.

Në rastet kur kemi gjetur dobësi dhe kur n'a është kërkuar kemi dhënë këshilla dhe rekomandime dhe përgjithësisht kjo ka dhënë rezultate të mira. Aty ku kemi vërejtur pa qartësi kemi adresuar dhe përmes udhëzimeve administrative kemi intervenuar për të sanuar zgjidhjet ekzistuese. Në këtë plan KRPP-ja ka nxjerr tri Udhëzime Administrative në vitin 2014.

Mirpo edhe përkundër ndërhyrjeve përmes Udhëzimeve Administrative në përmirsimin e LPP-së, konsiderojmë se amandamentimi I LPP-së është nevojë imediate për të ndërtuar një sistem të qëndrueshëm të prokurimit publik, me synim ndërtimin e një sistemi të balancuar të tregut në Kosovë, si dhe për të realizuar një sistem dinamik të prokurimit si përgjegjëje ndaj krizës ekonomike nëpër të cilën po kalon vendi yni.

Ky raport paraqet sfidat me të cilat duhet të përballemi dhe t'i adresojmë për të përmirësuar sektorin publik.

Shpresoj që ky raport t'ju ofrojë një pasqyrë mbi sistemin aktual të prokurimit publik në Kosovë dhe t'ju shërbej sa më mirë në radhë të parë institucioneve që përkujdesën për ligjin në Kosovë, autoriteteve kontraktuese, operatorëve ekonomik, si dhe qytetarëve që të jenë prezent dhe të kenë mundësin të përcjellin ndryshimet pozitive që po zhvillohen në këtë sistem në përgjithësi.

I vetëdijshëm për mangësit që mund të këtë raporti, pres me pa durim që ky raport të pasurohet dhe të plotësohet me vërtetë dhe komentet tuaja!

Kryetar i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik

Safet HOXHA

Prishtinë, shkurt 2015

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Duke u bazuar në Nenin 87.2.13 të Ligjit për Prokurim Publik, Nr. 04/L-042, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) për çdo vit kalendarik duhet të përgatisë dhe dorëzojë në Qeveri dhe Kuvend një raport vjetor që analizon aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për atë vit kalendarik, së bashku me rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik dhe/ose përmirësimin e këtij ligji, raport ky që dorëzohet jo më vonë se në fund të Shkurtit të vitit vijues kalendarik

Ky raport është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për Prokurim Publik, duke paraqitur një analizë mjaft të detajuar mbi të gjitha aktivitetet e prokurimit publik të zhvilluara në Kosovë, sipas kontratave të nënshkruara publike gjatë periudhës 01 janar - 31 dhjetor 2014.

Përgatitja e këtij raporti përmbush edhe kërkesën e Nenit 87.2.12 të Ligjit për Prokurim Publik, sipas të cilit KRPP-ja duhet t'i grumbullojë, t'i analizojë dhe t'i publikojë informacionet për procedurat e prokurimit publik dhe kontratat e dhëna publike.

Është ky viti i dhjetë me radhë që KRPP-ja përgatit një raport të tillë, duke u munduar që për çdo vit ta avancojë dhe ta kompletojë atë sa më shumë që të jetë e mundur, me qëllim që Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës, ta kenë një pasqyrë të plotë mbi të gjitha aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë të zhvilluara gjatë vitit 2014.

Ky raport do të jetë mjaft i mirëseardhur edhe për të gjitha institucionet financiare monetare ndërkombëtare që operojnë në Kosovë, sepse do të kenë në dispozicion një raport në të cilin përfshihen aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë sipas burimeve të financimit, vlerave të kontratave të prokurimit, llojeve të aktiviteteve të prokurimit, si dhe procedurave të prokurimit.

2. KORNIZA LIGJORE

2.1 Baza ekzistuese ligjore që e rregullon Agjencinë

Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik (KRPP) është themeluar në bazë të Pjesës VI të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik.

Sipas nenit 86 të këtij ligji, KRPP-ja është agjenci e pavarur rregullative dhe sipas nenit 87 të këtij ligji është përgjegjëse për zhvillimin, funksionimin dhe mbikqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë dhe i ushtron funksionet që i jepen nga ky ligj.

Me qëllim të funksionimit të mirë, KRPP ka nxjerrë Rregulloren e Punës, si dhe ka nxjerrë Udhëzime Operative për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, i cili ofron një sërë udhëzime operative praktike për menaxhmentin dhe stafin e KRPP-së. Udhëzimet Operative ofrojnë një prezantim të strukturuar dhe të kuptueshëm të KRPP-së në përgjithësi, roleve, përgjegjësi dhe kompetencave, si dhe udhëzime specifike për implementimin e funksioneve të KRPP-së që i janë dhënë me këtë ligj.

Udhëzimet janë përgatitur në mënyrë që të lehtësojnë prezantimin e Rregullave Procedurale si dhe të udhëzojnë menaxhmentin dhe stafin e KRPP-së përgjatë procedurave të ndryshme shqyrtuese dhe administrative të cilat janë pjesë e operacioneve të përditshme.

Që të dy aktet e brendshme të KRPP-së: Rregullorja e punës, si dhe Udhëzimet Operative për Komisionin Rregullativ për Prokurimin Publik janë të publikuara në ueb-faqen e KRPP-së.

3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT (ORGANIZIMI INSTITUCIONAL)

3.1 Misioni/Vizioni

Misioni i KRPP-së zhvillimi, funksionimi dhe mbikqyrja e përgjithshme e sistemit të prokurimit publik në Kosovë.

Vizioni i KRPP-së është zhvillimi dhe funksionimi i rregullave për prokurimin publik, si dhe përmirësimi i vazhdueshëm i sitetimit të prokurimit publik në Kosovë.

Për këtë qëllim, KRPP gjatë periudhës raportuese ka përgatitë dhe shpallë shtatë Udhëzues Administrativ si në vijim:

1. UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 1/2014

Për përgatitjen e Specifikave Teknike për Kontratat për Punë;

2. UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 02/2014

Për Sigurinë e Tenderit, Sigurimin e Ekzekutimit dhe Aplikimin e kriterit përzgjedhës ekonomik dhe financiar.

3. UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 3/2014

Për Disponueshmërinë e mjeteve për udhëheqje të aktiviteteve të prokurimit

Udhëzuesit Administrativ me numër rendor 1, 2 dhe 3 kanë hyrë në fuqi me 8 Janar 2014.

4. UDHËZUES A03 për plotësimin e Njoftimit Paraprak;

5. UDHËZUES A04 për Plotësimin e Njoftimit për Kontratë;

6. UDHËZUES A05 për Plotësimin e Njoftimit për dhënie të Kontratës;

7. UDHËZUES A06 për Plotësimin e Njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit;

Udhëzuesit Administrativ me numër rendor 4, 5, 6 dhe 7 kanë hyrë në fuqi 01 Maj 2014.

Qëllimi i nxjerrjes së udhëzuesve të lartpërmendur ishte përmirësimi i gabimeve të autoriteteve kontraktuese gjatë përdorimit të Dosjeve standarde të Tenderit dhe Formularëve Standard.

KRPP gjatë periudhës raportuese ka arritë të përmirësojë për 90% sistemin e prokurimit publik në Kosovë që nga 1 Maji i vitit 2014 kur ka filluar t'i kontrrollojë gabimet e lëshuara në Njoftimet për Kontratë dhe mos të lejojë publikimin e Njoftimeve për Kontratë me gabime. Më saktësisht ka eliminuar vendosjen e kriterëve diskriminues në Njoftimet për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.

3.2 Kompetencat e Agjencisë sipas ligjit

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Neni 86 i këtij ligji

1. KRPP është agjenci e pavarur rregullatore, që do të thotë se asnjë zyrtar publik nuk mund të ushtrojë ose të përpiqet të ushtrojë ndikim në KRPP në lidhje me ndonjë veprim ose vendim të caktuar operacional apo rregullativ të KRPP-së.
2. KRPP është autoritet publik dhe organizatë buxhetore. KRPP është subjekt i të gjitha dispozitave të zbatueshme të ligjeve dhe rregulloreve të Kosovës në të njëjtën masë sikurse autoritet e tjera publike ose organizatat buxhetore.

Funksionet Themelore të KRPP-së – neni 87 I këtij ligji

1. KRPP është përgjegjëse për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë, dhe i ushtron funksionet që i jepen nga ky ligj.
2. Përveç çështjeve të parapara më lartë, KRPP ka përgjegjësinë dhe autorizimin që:
 - 2.2. të lëshoj një urdhëresë që kërkon nga zyrtarët e zbatimit të ligjit të asistojnë KRPP-në që të sigurojnë përputhshmërinë me një urdhëresë tjetër të KRPP-së;
 - 2.3. tu ofroj opinione autoriteteve kontraktuese në lidhje me vendimet e tyre, veprat apo anashkalimet gjatë aktiviteteve të prokurimit dhe menaxhimit të kontratave;
 - 2.4. të ekzaminoj raportet nga autoritetet kontraktuese në lidhje me zbatimin e paragrafit 4 neni 32 dhe neni 35 të këtij ligji;
 - 2.5. të vendosë rregulla të hollësishme për të siguruar zbatimin adekuat të këtij ligji nga autoritetet kontraktuese si dhe rregulla për përdorimin dhe ekzekutimin e secilën nga procedurat e përcaktuara në nenet 33-37 të këtij ligji; me kusht që, këto rregulla të jenë në përputhje me kërkesat dhe parimet e përcaktuara në këtë ligj si dhe çfarëdo kërkesë të detyrueshme të BE-se për prokurim;

- 2.6. të përgatisë dhe shpërndajë doracakë të prokurimit, udhëzues, formularë dhe modele standarde për dokumentet e tenderit dhe të kontratave sipas këtij ligji në dobi të autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik;
- 2.7. të përforcojë vetëdijen në mesin e autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik për legjislacionin e prokurimit publik si dhe objektivat, procedurat dhe metodat e tij;
- 2.8. t'u japë ndihmë teknike dhe këshilla autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të këtij ligji si dhe për të çdo dokument që nxirret nga KRPP;
- 2.9. të nxjerrë dhe publikojë interpretime me shkrim të vendimeve administrative për të dyjat, autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të këtij ligji dhe çdo dokumenti të nxjerrë nga KRPP-ja;
- 2.10. të krijojë dhe të mirëmbajë një Regjistër elektronik të Prokurimit Publik që shërben si vend për ruajtjen e kopjeve elektronike të të gjitha njoftimeve, ftesave, deklaratave, dosjeve të tenderit, raporteve, ankesave dhe vendimeve të arkivuara ose të nxjerra në lidhje me çdo aktivitet prokurimi të kryer ose të iniciuar nga një autoritet kontraktues;
- 2.11. të krijojë sisteme manuale dhe elektronike për monitorimin e zbatimit të këtij ligji nga ana e autoriteteve kontraktuese, duke përfshirë përgatitjen e formularëve të raportimit që duhet të plotësohen nga të gjitha autoritetet kontraktuese subjekte të këtij ligji;
- 2.12. të grumbullojë, analizojë dhe publikojë informacionet për procedurat e prokurimit publik dhe kontratat publike të dhëna;
- 2.13. për çdo vit kalendarik të përgatisë dhe dorëzojë në Qeveri dhe Kuvend një raport vjetor që analizon aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për atë vit kalendarik, së bashku me rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik dhe/ose përmirësimin e këtij ligji, raport ky që dorëzohet jo më vonë se në fund të Shkurtit të vitit vijues kalendarik;
- 2.14. të krijojë dhe mirëmbajë një webfaqe informative në internet që i ofron publikut qasje të pa kufizuar në (i) këtë ligj dhe gjithë legjislacionin sekondar të nxjerrë sipas këtij ligji, (ii) interpretimet dhe dokumentet e përcaktuara në këtë nen dhe (iii) të gjitha informacionet që përmbahen në Regjistrin e Prokurimit Publik;
- 2.15. të zhvillojë një webfaqe dhe një sistem elektronik informativ në mbarë Kosovën për të përmirësuar publikimin e njoftimeve të kërkuara nga ky ligj;
- 2.16. të mbështesë IKAP dhe autoritetet tjera publike të trajnimit dhe arsimimit për të siguruar arritjen dhe mbajtjen e një niveli të lartë kompetence në radhët e zyrtarëve të prokurimit dhe profesionistëve të tjerë të prokurimit për zbatimin e praktikave të shëndosha të prokurimit dhe për respektimin e këtij ligji;
- 2.17. të mbështesë zhvillimin e prokurimit elektronik, ankandit elektronik dhe komunikimit brenda fushës së prokurimit publik;

2.18. të përgatisë dhe mbajë një listë të autoriteteve kontraktuese që i identifikon të gjitha entitetet që janë subjekt i këtij ligji, me kusht që nëse KRPP-ja nuk e përfshin një entitet në këtë listë, kjo (mos-përfshirja) të mos vendosë çështjes se nëse entiteti është jo autoritet kontraktues në kuptim të këtij ligji; dhe

2.19. të ndër veprojë dhe të bashkëpunojë me organizata të tjera brenda dhe jashtë vendit për çështjet që lidhen me prokurimin publik.

2.20. të zhvilloj dhe implementoj rregullat e detajuara në lidhje me shitjen e aseteve të Autoriteteve Kontraktuese.

Funksionet e vëzhgimit dhe të mbikqyrjes të KRPP-së – neni 88 i këtij ligji

1. KRPP ka gjithashtu autoritetin dhe përgjegjësinë të vëzhgojë dhe mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të nxjerra nga KRPP sipas autorizimit të këtij ligji.

2. Për këtë qëllim, KRPP përgatit dhe zbaton një metodologji dhe mekanizëm të përshtatshëm raportimi të mbështetur nga një sistem elektronik i menaxhimit të informacionit që i mundëson asaj (i) të vëzhgojë zbatimin e këtij ligji; (ii) të përgatisë raporte mbi rezultatet dhe zbatimin që identifikojnë përparësitë dhe dobësitë në zbatimin e këtij ligji ose sistemit të prokurimit; (iii) të identifikojë ato fusha që kanë nevojë të përmirësohen dhe zhvillohen, (iv) të përgatisë raportet vjetore që kërkohen nga ky ligj në mënyrë që të japin një vlerësim të përgjithshëm por të saktë të gjendjes së sistemit kombëtar të prokurimit si dhe vlerësime të veçanta të shkallës së përputhjes/mospërputhjes nga autoritetet individuale kontraktuese; dhe (v) të bëjë rekomandimet e duhura për ndryshimin e legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit.

KRPP në strukturën e saj organizative ka këto departamente që i kryejnë funksionet në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj, si në vijim: DEPARTAMENTI I RREGULLAVE DHE I TRAJNIMEVE, sipas nenit 87 të këtij ligji ka këto kompetenca:

2.3 tu ofroj opinione autoriteteve kontraktuese në lidhje me vendimet e tyre, veprat apo anashkalimet gjatë aktiviteteve të prokurimit dhe menaxhimit të kontratave;

2.5 të vendosë rregulla të hollësishme për të siguruar zbatimin adekuat të këtij ligji nga autoritetet kontraktuese si dhe rregulla për përdorimin dhe ekzekutimin e secilën nga procedurat e përcaktuara në nenet 33-37 të këtij ligji; me kusht që, këto rregulla të jenë në përputhje me kërkesat dhe parimet e përcaktuara në këtë ligj si dhe çfarëdo kërkesë të detyrueshme të BE-se për prokurim;

- 2.6 të përgatisë dhe shpërndajë doracakë të prokurimit, udhëzues, formularë dhe modele standarde për dokumentet e tenderit dhe të kontratave sipas këtij ligji në dobi të autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik;
- 2.7 të përforcojë vetëdijen në mesin e autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik për legjislacionin e prokurimit publik si dhe objektivat, procedurat dhe metodat e tij;
- 2.8 t'u japë ndihmë teknike dhe këshilla autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të këtij ligji si dhe për të çdo dokument që nxirret nga KRPP;
- 2.18 të përgatisë dhe mbajë një listë të autoriteteve kontraktuese që i identifikon të gjitha entitetet që janë subjekt i këtij ligji, me kusht që nëse KRPP-ja nuk e përfshin një entitet në këtë listë, kjo (mos-përfshirja) të mos vendosë çështjes se nëse entiteti është jo autoritet kontraktues në kuptim të këtij ligji; dhe
- 2.19 të ndër veprojë dhe të bashkëpunojë me organizata të tjera brenda dhe jashtë vendit për çështjet që lidhen me prokurimin publik.
- 2.20 të zhvilloj dhe implementoj rregullat e detajuara në lidhje me shitjen e aseteve të Autoriteteve Kontraktuese.

DIVIZIONI I TRAJNIMEVE DHE INTEGRIMEVE EUROPIANE, sipas nenit 87 të këtij ligji ka këto kompetenca:

- 2.16 të mbështesë IKAP dhe autoritetet tjera publike të trajnimit dhe arsimimit për të siguruar arritjen dhe mbajtjen e një niveli të lartë kompetence në radhët e zyrtarëve të prokurimit dhe profesionistëve të tjerë të prokurimit për zbatimin e praktikave të shëndosha të prokurimit dhe për respektimin e këtij ligji;

DEPARTAMENTI I MONITORIMIT DHE I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE sipas nenit 81, 87 dhe 88 të këtij ligji, ka këto kompetenca:

DIVIZIONI I MONITORIMIT, sipas nenit 81, 87 dhe 88 të këtij ligji ka këto kompetenca:

- 88.1 Monitoron menaxhimin e kontratave;
- 2.1. të kryej hetimet e aktiviteteve të prokurimit dhe menaxhimit të kontratave për qëllim të monitorimit të zbatimit të këtij ligji;
- 2.2. të lëshoj një urdhëresë që kërkon nga zyrtarët e zbatimit të ligjit të asistojnë KRPP-në që të sigurojnë përputhshmërinë me një urdhëresë tjetër të KRPP-së;
- 2.4. të ekzaminoj raportet nga autoritetet kontraktuese në lidhje me zbatimin e paragrafit 4 neni 32 dhe neni 35 të këtij ligji;

- 2.12. të grumbullojë, analizojë dhe publikojë informacionet për procedurat e prokurimit publik dhe kontratat publike të dhëna; si dhe
- 88.1 Të vëzhgojë dhe mbikqyrë zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të nxjerra nga KRPP sipas autorizimit të këtij ligji.

DIVIZIONI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE, sipas nenit 87 të këtij ligji, ka këto kompetenca:

- 2.9 të nxjerrë dhe publikojë interpretime me shkrim të vendimeve administrative për të dyjat, autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të këtij ligji dhe çdo dokumenti të nxjerrë nga KRPP-ja;
- 2.10 të krijojë dhe të mirëmbajë një Regjistër elektronik të Prokurimit Publik që shërben si vend për ruajtjen e kopjeve elektronike të të gjitha njoftimeve, ftesave, deklaratave, dosjeve të tenderit, raporteve, ankesave dhe vendimeve të arkivuara ose të nxjerra në lidhje me çdo aktivitet prokurimi të kryer ose të iniciuar nga një autoritet kontraktues;
- 2.11 të krijojë sisteme manuale dhe elektronike për monitorimin e zbatimit të këtij ligji nga ana e autoriteteve kontraktuese, duke përfshirë përgatitjen e formularëve të raportimit që duhet të plotësohen nga të gjitha autoritetet kontraktuese subjekte të këtij ligji;
- 2.12 të grumbullojë, analizojë dhe publikojë informacionet për procedurat e prokurimit publik dhe kontratat publike të dhëna;
- 2.13 për çdo vit kalendarik të përgatisë dhe dorëzojë në Qeveri dhe Kuvend një raport vjetor që analizon aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për atë vit kalendarik, së bashku me rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik dhe/ose përmirësimin e këtij ligji, raport ky që dorëzohet jo më vonë se në fund të Shkurtit të vitit vijues kalendarik;
- 2.14 të krijojë dhe mirëmbajë një webfaqe informative në internet që i ofron publikut qasje të pa kufizuar në (i) këtë ligj dhe gjithë legjislacionin sekondar të nxjerrë sipas këtij .
- 2.15. të zhvillojë një webfaqe dhe një sistem elektronik informativ në mbarë Kosovën për të përmirësuar publikimin e njoftimeve të kërkuara nga ky ligj;
- 2.17. të mbështesë zhvillimin e prokurimit elektronik, ankandit elektronik dhe komunikimit brenda fushës së prokurimit publik

4. FUSHËVEPRIMI QË E MBULON INSTITUCIONI

KRPP-ja ka tridhjetë e tri (33) pozita të aprovuara të punës nga këto njëzet e pesë (25) janë nëpunës civil kurse tre (3) janë Funkionar Publik (në bazë të LSHC-se) dy anëtarë të Bordit dhe Kryetari i KRPP-se. Pesë (5) vende pune janë ende të pa plotësuar. Mandati i bordit të KRPP-se është pesë (5) vjeçare, Kryetari dhe anëtarët e bordit të KRPP-se janë emëruar me vendimin e datës 08.07.2010 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Funksionet e Kryetarit të KRPP-se:

- Kryetari përfaqëson, menaxhon dhe organizon punën e KRPP-së dhe ka përgjegjësinë e përgjithshme për performancën e punëve ditore.
- Përgjegjësia për të kryer funksionet dhe aktivitetet e KRPP-së të cilat nuk janë përcaktuar apo përfshirë në ndonjë Departament bie mbi Kryetarin.
- Kryetari cakton njërin nga anëtarët për të organizuar dhe menaxhuar punën e KRPP-së në fusha të caktuara, në veçanti funksione specifike apo aktivitete të cilat nuk janë të përfshira në funksionet apo aktivitetet e Departamentit specifik të KRPP-së. Kryetari ka për të informuar anëtarët për ndonjë përcaktim të tillë. Një kopje e dokumentit në lidhje me delegimin e përgjegjësi do të bartet zyrtarit të personelit, i cili do të kujdeset për dosjen dhe të përfshijë ato përgjegjësi të deleguara herë pas here. Kryetari mund të ndryshoj këto përgjegjësi ashtu siç ai/ ajo i sheh të arsyeshme.
- Kryetari do të thërret takimet e Bordit të Drejtoreve të KRPP-së, kur dhe si ai konsideron të jetë e nevojshme apo kur kërkohet nga dy anëtarët e tjerë të KRPP-së.

Kryetari do të udhëheq takimet e Bordit të drejtoreve të KRPP-së. Në raste të jashtëzakonshme kur është e nevojshme që KRPP, të ketë një takim në mungesë të Kryetarit, ai duhet të autorizoj një nga anëtarët tjerë të Bordit të Drejtoreve të KRPP-së për të udhëhequr takimin.


- Kryetari:
- aprovon listën e vendeve të punës;
- aprovon përshtatjet e vendeve të punës;
- përcakton detyrat e nëpunësve të KRPP-së;
- shkarkon nëpunësit;
- ka përgjegjësi për menaxhimin e fondeve financiare të KRPP-së;

- përcakton një anëtarë tjetër për të prezantuar, menaxhuar, dhe organizuar punën e KRPP në mungesë të Kryetarit p.sh të ushtrij detyrën e Kryetarit. Ky person mund të ndryshojë prej një mungese në tjetrën;
- jep udhëzime duke siguruar qarkullimin e dokumenteve brenda KRPP-së;
- konkludon dhe nënshkruan marrëveshje dhe kontrata të nevojshme për të kryer funksionet e KRPP-së;
- nënshkruan dokumentet në emër të KRPP-së, nënshkruan të gjitha vendimet e arritura nga Bordi. Asnjë dokument zyrtar nuk duhet të lëshohet nga KRPP, i cili nuk është nënshkruar nga Kryetari;
- siguron se Rregullat e Procedurave Financiare të Ministrisë së Financave (MF) janë zbatuar nga secili punëtorë i KRPP-së, në fushat e tyre funksionale;
- monitoron dhe kontrollon shpenzimet e KRPP-së;
- siguron se të gjithë nënpunësit të cilët kanë përgjegjësi për administrimin financiar janë të këshilluar në mënyrën e duhur;
- siguron se ekziston një ndarje e qartë e detyrave brenda administrimit në të gjitha sistemet financiare dhe se kontrolli adekuat është vendosur.

Trajnimet e stafit të KRPP-se gjatë vitit 2014:

- Prill 2014 Tema - Vlerësimi i Rezultateve të Punës në Shërbimin Civil” – IKAP;
- Prill 2014 Tema - “SIMBNJ (Sistemi Informativ i Burimeve Njerëzore)” – MAP;
- Prill 2014 Tema – “Standardizimi i Vendeve të Punës”- IKAP;
- Prill 2014 Tema - Planifikimi i Personelit” – IKAP;
- Trajnime nga Fusha e Prokurimit Publik të Bazik dhe të Avancuar - IKAP.
- Qershor 2014 – Tema : “Sfidat e prokurimit publik” - Hungari;

ORGANOGRAMI I KRPP-SË



5. AKTIVITETET E PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË GJATË VITIT 2014

Duke u bazuar në Nenin 87 pika .2.18 të Ligjit për Prokurim Publik, Nr. 04/L-042, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik duhet të përgatisë dhe të mbajë një listë të plotë të gjitha autoriteteve kontraktuese në Kosovë, të cilat janë të obliguara ta zbatojnë Ligjin për Prokurim Publik. Gjatë vitit 2014 në Kosovë janë evidentuar 170 autoritete kontraktuese.

Nga gjithsejt 170 autoritete kontraktuese të evidentuara në fund të vitit 2014, 167 autoritete kontraktuese me kohë i kanë dorëzuar raportet vjetore. Tri (3) autoritete kontraktuese fare nuk i kanë dërguar raportet vjetore. Autoritetet kontraktuese, të cilat nuk i kanë dorëzuar raportet vjetore, janë komuna nga pjesa veriore e Kosovës si Komuna e Zveqanit, e Leposaviqit si dhe Trepça (në pjesën veriore).

Përmes raporteve vjetore mbi kontratat e nënshkruara publike, të cilat autoritetet kontraktuese gjatë janarit të vitit 2015, i kanë dërguar në mënyrë elektronike, departamenti i TI-së dhe Statistika i KRPP-së ka përgatitur Raportin përmbledhës vjetor për të gjitha prokurimet publike të zhvilluara në Kosovë gjatë vitit 2014.

Bazuar në raportet e dërguara nga autoritetet kontraktuese, shihet se gjatë vitit 2014 në tërë Kosovën janë nënshkruar 11362 kontrata publike të udhëhequra sipas Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës, duke i përfshirë të gjitha llojet e vlerave të kontratave.

Në vazhdim të raportit do t'i paraqesim prokurimet publike në Kosovë sipas kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2014. Duke pasur për bazë raportet e viteve paraprake, të përgatitura nga KRPP-ja sipas kërkesave të LPP-së, raporti në vijim paraqet aktivitetet e prokurimit, pra të gjitha kontratat e nënshkruara nga autoritetet kontraktuese, duke bërë një analizë të kontratave të nënshkruara sipas burimeve të financimit, llojit të autoriteteve kontraktuese, sipas llojit të kontratave, vlerës së kontratave, procedurave të përdorura, aneks kontratave, operatorëve ekonomikë të shpërblyer me kontratë, afateve kohore të publikimit dhe kriterëve të shpërblyerimit me kontratë.

Pra, raporti në vazhdim i pasqyron të gjitha aktivitetet e prokurimit publik të zhvilluara gjatë vitit 2014 në Kosovë, duke i analizuar dhe duke i krahasuar me vitet paraprake, me ç'rast do ta shohim trendin e zhvillimit të Prokurimit Publik në Kosovë.

5.1. NUMRI I KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2014

NUMRI I KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA				
Autoritetet kontraktuese:	Gjatë vitit 2011	Gjatë vitit 2012	Gjatë vitit 2013	Gjatë vitit 2014 ¹
Qeveritare	9305	9112	9682	9053
Kompani publike	3001	2910	2839	2295
Tjera/OJQ	4	23	30	14
Gjithsej:	12310	12045	12551	11362


Tabela 1

Duke u bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik të Kosovës, autoritetet kontraktuese janë të obliguara t'i paraqesin të gjitha kontratat e nënshkruara, duke përfshirë edhe ato me vlerë minimale.

Analizën e kontratave të nënshkruara po e fillojmë me ndarjen e autoriteteve kontraktuese në organizata buxhetore – Qeveritare, Kompani publike dhe të tjera-OJQ. Dihet mirëfilli se kjo ndarje nuk e paraqet një pasqyrë reale të financimit, pasi që një numër i konsiderueshëm i kompanive publike në Kosovë financohen ende nga BKK-ja. Sido që të jetë, ne do të mundohemi, duke u bazuar në këtë ndarje, ta pasqyrojmë numrin e kontratave të nënshkruara në tabelën nr. 1 dhe në grafikun nr. 1 gjatë katër viteve të fundit nga autoritetet kontraktuese në fjalë.

Edhe gjatë viti 2014 janë përdorur Kontratat Kornizë nga autoritetet kontraktuese. Pra tani kan filluar të përdoren këto llojë të kontratave thuaja nga të gjitha AK, sidomos vrehet një përdorim i theksuar te autoritetet kontraktuese si Agjencioni Qendror i Prokurimit, Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosoves SH.A. Vlera e këtyre kontratave është e pamundur të saktësohet pasi që kryesisht këto kontrata janë nënshkruar me çmim për njësi, por mund të konstatojm se vlera e tyre është e lartë pasi që kemi të bëjmë kryesisht me furnizime si derivatet dhe sherbime si sigurime të objekteve, mirmbajtje të objekteve etj. të cilat arrijnë një shumë të konsideruar në prokurimet e zhvilluara në Kosovë.

¹ Në numrin e kontratave të nënshkruara janë përfshirë edhe 339 aneks kontrata.



Grafikoni 1

5.2. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2014

VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA (€)				
Autoritetet kontraktuese:	Vlera e kontratave 2011	Vlera e kontratave 2012	Vlera e kontratave 2013	Vlera e kontratave 2014 ²
Qeveritare	284,714,229.60	318,593,149.16	348,631,297.84	259,686,575.89
Kompani publike	267.260.689,03	188,565,175.83	93,626,952.26	129,579,279.93
Tjera	175.849,56	704,978.90	1,923,149.00	472,102.78
Gjithsej :	552,150,768.20	507,863,303.89	444,181,399.10	389,737,958.60
Autostradat:	236,165,999.52 ³	235,379,330.33 ⁴	210,549,681.92 ⁵	55,468,528.85 ⁶

Tabela 2

² Në vlerën e kontratave të nënshkruara është përfshirë edhe vlera e aneks kontratave në vlerë reje **5,576,308.88€**


³ Kontrata: Autostrada Morinë-Merdare, Rruga 7 nga MI ,pjesa e paguar gjatë vitit 2011

⁴ Kontrata: Autostrada Morinë-Merdare, Rruga 7 nga MI, pjesa e paguar gjatë vitit 2012

⁵ Kontrata: Autostrada Morinë-Merdare, Rruga 7 nga MI, pjesa e paguar gjatë vitit 2013


⁶ Kontrata: Autostrada Prishtinë- Hani i Elezit, Rruga 6, Pjesa e parashikuar gjatë vitit 2014 prej **55,468,528.85€** nga M Infrastruktura, e cila kontratë në tërësi është në vlerë prej **599,944,263.54€**, e nënshkruar gjatë vitit 2014.

Siq mund të vrehet nga tabela 2 kemi të pasqyruar vlerën e kontratave të nënshkruara gjatë katër viteve të fundit. Kontratën për ndërtimin e Autostradës Morinë-Merdare, e kemi paraqitur si kontratë të veçantë pasi që kontrata në fjalë është kontratë me vlerë të madhe dhe sipas Ministrisë së Infrastruktura kjo kontratë është afatëgjatë dhe vlera e parashikuar për vitin 2010 ishte 106,883,295.92€, për vitin 2011 arrin 236.165.999,52€, për vitin 2012 është 235,379,330.33€, dhe vlera e parashikuar gjatë vitit 2013 ishte 210,549,681.92€.




Grafikoni 2

Gjithashtu gjatë vitit 2014 është nënshkruar kontrata për ndërtimin e Autostradës Prishtinë- Hani i Elezit, Rruga 6, nga M. Infrastruktura - në vlerë prej 599,944,263.54€, dhe vlera e parashikuar për vitin 2014 ishte 55,468,528.85€ të cilën po e pasqyrojmë në grafikun 2 .



Grafikoni 3

Në bazë të klasifikimit të autoriteteve kontraktuese, si më lartë në tabelën nr.2 dhe grafikonin nr.3 pasqyrohet vlera e kontratave të nënshkruara, gjatë katër viteve të fundit.



Grafikoni 4

Grafikoni nr.4 e pasqyron strukturën, apo pjesëmarrjen e vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2014. Organizatat buxhetore - qeveritare marrin pjesë me 66,64%, kompanitë publike me 33,24%, derisa te autoritetet tjera – OJQ-të me vetëm 0.12% në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara.

5.3. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2014 SIPAS BURIMEVE TË FINANCIMIT


VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS BURIMEVE TË FINANCIMIT (€)				
Burimet e financimit:	Vlera e kontratave 2011	Vlera e kontratave 2012	Vlera e kontratave 2013	Vlera e kontratave 2014
Të hyrat vetanake ⁷	222.248.360,71	188,565,175.83	93,991,324.00	129,808,495.46
Buxheti i Kons. i Kosovës	323,841,023.84	314,128,078.32	343,489,659.92	258,872,264.05
Donacione	6.061.383,65	5,170,049.74	6,700,415.18	1,057,198.09
Gjithsej :	552,150,768.20	507,863,303.89	444,181,399.10	389,737,957.60
Autostradat:	236,165,999.52	235,379,330.33	210,549,681.92	55,468,528.85

Tabela 3

Në tabelën nr. 3 dhe grafikonin nr. 4 është pasqyruar vlera e kontratave të nënshkruara, duke pasur për bazë burimin e financimit. Nga të hyrat vetanake vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2014 është 129,808,495,46€. Nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës vlera e kontratave të nënshkruara arrin 258,872,264,05€, derisa nga donacionet vlera e kontratave të nënshkruara arrin 1,057,198,09€.

⁷ Të hyrat vetanake paraqesin të hyrat e kompanive publike.


Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë viteve 2011 ,2012 , 2013 dhe 2014 sipas burimeve të financimit



Grafikoni 4

Struktura e vlerës së kontratave të nënshkruara sipas burimeve të financimit pasqyrohet në grafikonin nr.5 ku të Hyrat vetanake të kompanive marrin pjesë me 33.31%, Buxheti i Konsoliduar i Kosovës me 66.42 %, kurse nga donacionet me 0.27%.

Pjesëmarrja në vlerën e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2014 sipas burimeve të financimit



Grafikoni 5

5.4. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2014 SIPAS LLOJIT TË PROKURIMIT


VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS LLOJIT TË PROKURIMIT (€)				
Lloji i prokurimit:	Vlera e kontratave 2011	Vlera e kontratave 2012	Vlera e kontratave 2013	Vlera e kontratave 2014
Furnizim	308,709,092.99	193,136,785.94	138,220,130.76	178,156,399.66
Shërbime ⁸	64,305,010.99	99,274,281.42	45,351,704.76	52,011,485.30
Konkurs i projektimit	2,158,906.03	1,207,952.71	734,756.75	234,327.18
Punë	176,977,758.19	214,244,283.82	259,874,806.83	159,335,745.46
Gjithsej :	552,150,768.20	507,863,303.89	444,181,399.10	389,737,957.60
Autostradat:	236,165,999.52	235,379,330.33	210,549,681.92	55,468,528.85

Tabela 4

Bazuar në llojin e prokurimit, që kontratat kanë si objekt të tyre, në tabelën nr. 4 dhe grafikonin nr. 6, vlera e kontratave të nënshkruara për furnizime gjatë vitit 2014 arrin në 178,156,399.66€. Vlera e kontratave të nënshkruara për shërbime është 52,011,485.30€, dhe vlera e kontratave të nënshkruara për konkurs projektimi është 234,327.46€.


Ndërsa vlera e kontratave të nënshkruara për punë arrin në 159,335,745.46€, dhe kësaj vlere nëse ja shtojm edhe vlerën e Autostradës Prishtinë- Hani i Elezit në shumë e planifikuar për vitin 2014, prej 55,468,528.85€, vlera e kontratave për punë gjatë vitit 2014 arrinë në 214,804,274,31€.

⁸ Në vlerën e kontratave për shërbime janë përfshirë edhe shërbimet e konsulencës.



Grafikoni 6


Grafikoni nr 7, paraqet strukturën, apo pjesëmarrjen e kontratave të nënshkruara, sipas vlerës në totalin e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2014.



Grafikoni 7

Kontratat për furnizime marrin pjesë me 45.71%. Kontratat për shërbime me 13.35%, kontratat për konkurse të projektimit me 0.06 %, ndërsa kontratat për punë marrin pjesë me 40.88% .

Derisa në grafikun nr.8 pasqyrohet struktura, apo pjesëmarrjen e kontratave të nënshkruara, sipas vlerës në totalin e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2014, ku vlerës së kontratave për punë i shtohet vlera e Autostradës Prishtinë- Hani i Elezit e paraparë për vitin 2014 prej 55,468,528,85€ dhe vlera e gjithmbarshme e kontratave për punë gjatë vitit 2014 arrinë 214,804,274,31€ apo 48.25% në vlerën e gjithmbarshme të kontratave të nënshkruara. Kontratat për furnizime marrin pjesë me 40.02%. Kontratat për shërbime me 11.68%, kontratat për konkurse të projektimit me 0.05%.



Grafikoni 8

5.5 KONTRATAT E NËNSHKRUARA MBI PRAGJET E BE-së

Duke u bazuar në kërkesat e Institucioneve të BE-së, për nxjerrjen e informatave mbi kontratat e nënshkruara, sipas pragjeve të BE-së, për herë të parë gjatë vitit 2014, KRPP-ja ka grumbulluar të dhënat mbi këto kontrata. Në tabelën 4.a janë paraqitur kontratat e nënshkruara sipas numrit dhe vlerës të cilat janë më të mëdha se pragjet e BE-së, sipas vlerave për vitin 2014.

KONTRATAT E NËNSHKRUARA MBI PRAGJET E BE-së (€)		
Lloji i prokurimit:	Numri i kontratave 2014	Vlera e kontratave 2014
Furnizim (mbi 134,000.00 €)	90	66,881,992.14
Shërbime (mbi 134,000.00 €)	40	14,590,030.36
Punë (mbi 5,186,000.00 €) (Pjesa e Autostradës Prishtinë - Hani i Elezit, Rruga 6) ⁹	1	55,468,528.85
Gjithsejtë:	131	136,940,551.35

Tabela 4.a


2.6 KONTRATAT E NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2014 SIPAS VLERËS SË PROKURIMIT

VLERAT E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS VLERËS SË PROKURIMIT (€)				
Lloji i vlerës së prokurimit:	Vlera e kontratave 2011	Vlera e kontratave 2012	Vlera e kontratave 2013	Vlera e kontratave 2014
Vlerë e madhe	362,942,453.16	306,168,146.54	247,402,583.69	246,119,956.60
Vlerë e mesme	163,603,179.07	173,773,476.01	167,549,046.07	119,138,144.07
Vlerë e vogël	23,111,720.20	25,531,901.39	26,706,716.04	22,190,827.65
Vlerë minimale	2,493,415.77	2,389,779.95	2,523,053.30	2,289,029.28
Gjithsej :	552,150,768.20	507,863,303.89	444,181,399.10	389,737,957.60
Autostradat:	236,165,999.52	235,379,330.33	210,549,681.92	55,468,528.85

Tabela 5

⁹ Kontrata: Autostrada Prishtinë- Hani i Elezit, Rruga 6, Pjesa e parashikuar gjatë vitit 2014 prej **55,468,528.85€** nga M Infrastruktura, e cila kontratë në tërësi është në vlerë prej **599,944,263.54€**, e nënshkruar gjatë vitit 2014.


Kontratat e nënshkruara, të ndara sipas llojit të vlerave të kontratave, në tabelën nr. 5 dhe në grafikonin nr.9, na pasqyrojnë se, sipas vlerës së madhe, vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2014 është 246,119,956.60€.



Grafikoni 9

Kontratat e nënshkruara me vlerë të mesme arrijnë shumën prej 119,138,144.07€, vlera e kontratave të nënshkruara me vlerë të vogël është 22,190,827.65€. Vlera e kontratave të nënshkruara me vlerë minimale është 2,289,029.28€.

Struktura e vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2014
sipas llojit të vlerës së prokurimit



Grafikoni 10

Në bazë të grafikomit nr.10, vërehet se pjesëmarrja e kontratave me vlera të mëdha, në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2014, është 63.15%. Kontratat me vlera të mesme marrin pjesë në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara me 30.57%. Kontratat me vlerë të vogël marrin pjesë në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara me 5.69%, derisa kontratat me vlerë minimale marrin pjesë me 0.59%.

5.7 VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2014 SIPAS PROCEDURAVE TË PROKURIMIT


VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS PROCEDURAVE TË PROKURIMIT (€)				
Lloji i procedurave:	Vlera e kontratave 2011	Vlera e kontratave 2012	Vlera e kontratave 2013	Vlera e kontratave 2014
Procedurë e hapur	457,187,278.28	426,605,842.24	390,277,502.17	282,717,895.34
Procedurë e kufizuar	7,450,000.80	0.00	0.00	281,264.21
Konkurs projektimi	2,158,906.02	1,193,137.72	734,756.75	47,883.00
E negociuar pas publikimit të njoftimit të kontratës	26,600,075.83	507,289.75	75,093.31	31,924,923.00
E negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës	34,295,214.22	53,035,295.31	24,902,026.04	50,591,999.50
Kuotimi i çmimeve	21,971,811.73	24,124,914.80	25,656,613.16	21,888,064.14
Procedurë për vlerë minimale	2,487,481.32	2,396,824.07	2,535,407.67	2,285,928.41
Gjithsej :	552,150,768.20	507,863,303.89	444,181,399.10	389,737,957.60
Autostradat:	236,165,999.52	235,379,330.33	210,549,681.92	55,468,528.85

Tabela 6


Analiza e kontratave të nënshkruara, të ndara sipas llojit të procedurave në tabelën nr. 6 dhe në grafikun nr.11, tregon se vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurës së hapur gjatë vitit 2014 është 282,717,895.34€. Sipas procedurës së kufizuar gjatë vitit 2014 281,264.21€.

Vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurës konkurs projektimi, gjatë vitit 2014, është 47,883.00€, derisa vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurës së negociuar pas publikimit të njoftimit të kontratës, gjatë vitit 2014, është 31,924,923.00€. Kurse sipas procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës është 50,591,999.50€ dhe vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurës kuotim i çmimeve, gjatë vitit 2014, është 21,888,064.14€.

Ndërkaq, sipas procedurës për vlerë minimale, vlera e kontratave të nënshkruara, gjatë vitit 2014, është 2,285,928.41€.



Grafikoni 11




Grafikoni 12

Analiza e strukturës, apo e pjesëmarrjes së procedurave të zbatuara gjatë vitit 2014, në grafikonin nr. 12, na tregon se pjesëmarrja e procedurës së hapur në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara është 72.55%, e cila është nga procedurat e përdorura më së shumti dhe e njohur si procedura më transparente.

Gjithashtu edhe pjesëmarrja e procedurës së negociuar pas publikimit të njoftimit të kontratës është 8.19%. Dhe pjesëmarrja e procedurës së negociuar pa publikimit të njoftimit të kontratës gjatë vitit 2014 është 12.98%.


Pjesëmarrja e procedurave sipas koutimit të çmimeve është 5.62% dhe sipas vlerës minimale merr pjesë me 0.58%, e kufizuar 007%, kurse konkurset e projektimit marrin pjesë vetëm me 0.01% në vlerën e kontratave të gjithëmbarshe të nënshkruara gjatë vitit 2014.



Grafikoni 13


Grafikoni 13 pasqyron përdorimin e procedurave të prokurimit te organizatat buxhetore apo Qeveritare. Derisa grafikoni 14 pasqyron përdorimin e procedurave të prokurimit te Kompanit Publike dhe grafikoni 15 paraqet përdorimin e procedurave të prokurimit te organizatat tjera-OJQ-të.

Kompani Publike: Pjesëmarrja në vlerën e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2014 sipas procedurave të prokurimit



Grafikoni 14

Tjera-OJQ: Pjesëmarrja në vlerën e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2014 sipas procedurave të prokurimit




Grafikoni 15

5.8 VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2014 SIPAS LLOJIT DHE PROCEDURAVE TË PROKURIMIT

VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS LLOJIT DHE PROCEDURAVE TË PROKURIMIT 2014 (€)								
Procedurat e prokurimit								
Lloji prokurimit	E hapur	E kufizuar	Konkurs projektimi	E neg. pas publikimit të njoftimit të kont.	E neg.pa publikim të njoftimit të kont.	Kuotim i çmimeve	Procedur vlera minimale	Gjithsej:
Furnizim	109,873,045.70	160,188.32	-	31,924,923.00	23,076,191.93	11,358,817.83	1,763,232.89	178,156,399.67
Shërbime	36,046,397.49	118,315.89	40,000.00	-	8,751,817.50	6,557,629.44	497,324.97	52,011,485.29
Konkurs projektim	202,094.18	-	7,883.00	-	19,500.00	4,850.00	-	234,327.18
Punë	136,596,357.96	2,760.00	-	-	18,744,490.07	3,966,766.87	25,370.56	159,335,745.46
Gjithsej	282,717,895.33	281,264.21	47,883.00	31,924,923.00	50,591,999.50	21,888,064.14	2,285,928.42	389,737,957.60

Tabela 7

Në tabelën nr. 7 dhe grafikun nr. 16 kemi të pasqyruar vlerën e kontratave të nënshkruara sipas llojit dhe ndërthurjen e tyre me vlera të kontratave sipas procedurave të prokurimit gjatë vitit 2014. Këtu, pra, pasqyrohet secili lloj i prokurimit ndaj procedurës së zbatuar të prokurimit.




Grafikoni 16

5.9 KONTRATAT E NËNSHKRUARA DHE ANEKS-KONTRATAT GJATË VITIT 2014

VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA DHE ANEKS-KONTRATAVE GJATË VITIT 2012,2013 DHE 2014 (€)						
Kontratat:	Vlera 2012 (€)	Pjesmarrja 2012 %	Vlera 2013 (€)	Pjesmarrja 2013 %	Vlera 2014(€)	Pjesmarrja 2014 %
Kontratat e nënshkruara	504,059,800.76	99.25	438,711,554.85	98.77	384,161,648.72	98.57
Aneks-kontratat	3,803,503.13	0.75	5,469,844.25	1.23	5,576,308.88	1.43
Gjithsej :	507,863,303.89	100.00	444,181,399.10	100.00	389,737,957.60	100.00

Tabela 8



Grafikoni 16.a

Sic shihet nga tabela e mësipërme nr.8 dhe grafikoni nr.16a vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2014 është 384,161,648.72€, me një pjesëmarrje prej 98.57% në vlerën e gjithëmbarshme të kontratave të nënshkruara e që është 389,737,957.60€, kurse vlera e aneks kontratave arrin në 5,576,308.88€, apo me pjesëmarrje 1.43% në vlerën e gjithëmbarshme të kontratave të nënshkruara e që është 389,737,957.60€.

5.10 VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS OPERATORËVE EKONOMIK VENDORË DHE JOVENDORË

VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA OE VENDORË – JOVENDORË GJATË VITIT 2011,2012 DHE 2014 (€)				
Operatorët ekonomik:	Vlera e kontratave 2011	Vlera e kontratave 2012	Vlera e kontratave 2013	Vlera e kontratave 2014
Operatorët vendor	411,401,311.14	417,611,791.96	412,984,556.80	328,861,866.25
Operatorët jovendor	140,749,457.06	90,251,511.93	31,196,842.30	60,876,091.35
Gjithsej :	552,150,768.20	507,863,303.89	444,181,399.10	389,737,957.60
Autostradat:	236,165,999.52	235,379,330.33	210,549,681.92	55,468,528.85

Tabela 9

Sipas Nenit 87.2.13, të Ligjit për Prokurim Publik Nr. 04/L-042, KRPP-ja së bashku me raportin vjetor në Qeveri dhe Kuvend duhet të dorëzojë edhe rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik dhe/ose përmirësimin e këtij ligji.

Me qëllim të avancimit dhe përmirësimit të sistemit të prokurimit publik në Kosovë, KRPP-ja i propozon Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës, si dhe institucioneve tjera që merren me fushën e prokurimit publik, që të ndërmarrin këta hapa:

- Amandamentimin sa më shpejt që të jetë e mundur të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 04/L-042;
- Inkorporimin e disa nga kërkesat që dalin nga Direktivat e reja të BE-së, të vitit 2014, dhe të cilat janë të arsyeshme për sistemin e prokurimit publik në Kosovë;
- Korrigjimin e disa neneve të LPP-se, të cilët nuk janë zbatuar siç duhet, ose të cilët kanë shkaktuar vështirësi gjatë implementimit të LPP-së;
- Plotësimin e bazës ligjore për zbatimin e prokurimit elektronik;
- Qeveria e Kosovës të nxjerrë rregulla në lidhje me përdorimin e metodave të prokurimit elektronik nga autoritetet kontraktuese, sipas kërkesave të Nenit 129.1 të LPP-së Nr. 04/L-042;
- Qeveria në koordinim me KRPP-në, të nxjerrë rregulla në lidhje me pajisjet e dorëzimit elektronik, dhe pranimin e tenderëve si dhe për pajisjet për pranimin elektronik të kërkesave për pjesëmarrje. Këto rregulla duhet të përfshijnë një nënshkrim të avancuar elektronik, në pajtim me standardet ndërkombëtare, sipas kërkesave të Nenit 129.2 të LPP-së Nr. 04/L-042;
- Me rastin e amandamentimit të LPP-së Nr. 04/L-042, të ndryshohet Neni 129.4, i këtij ligji, duke ja bartur kompetencat të Qeveria, ose të KRPP-ja për të vendosur kohën e duhet për zbatimin e prokurimit elektronik në mënyrë obligative nga të gjitha AK të Kosovës;

- Të plotësohet Neni 99 i LPP-se, duke u parapa mundësia që një operator ekonomik të futet në listë të zezë nga OSHP-ja, edhe për “përmbushje të pa rregullt të kontratave”, e jo vetëm për “falsifikim të dokumenteve” siç përcaktohet me këtë nen;
- Neni 118 i LPP-së të ndryshohet duke u zvogëluar tarifa për ankesë nga 500 €, në 50 € për kontratat me vlera të vogla, në 100 € për kontratat me vlera të mesme dhe në 200 € apo 300 € për kontratat me vlera të mëdha;
- Të rregullohet me ligj që Bordet ekzistuese të KRPP-së dhe OSHP-së, të vazhdojnë kryerjen e detyrave e parapara me ligj deri ne zgjedhjen e Bordit të Ri, me qëllim që mos të shkaktohen zëbraztësira në funksionimin e institucioneve të prokurimit;
- Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Trajnimit në fushën e prokurimit publik;
- Trajnimet nga fusha e prokurimit publik, përveç zyrtarëve të prokurimit të organizohen edhe për grupe tjera të ndryshme, si p.sh. për stafin e nivelit menaxhues, për ekspert teknik të cilët përgatisin specifikimet teknike, për auditorët e përgjithshëm si dhe ata të brendshëm, etj.
- Të organizohen trajnime të mëtejshme që kane të bëjnë me menaxhimin e kontratave, jo vetëm për zyrtarët e prokurimit, por për stafin teknik dhe të tjerë të përfshirë në zbatimin e kontratës;
- Të ridefinohet me qartë Neni 25 LPP-së, Nr. 04/L-042, i cili ka të bëjë me trajnimin i Zyrtarëve të Prokurimit, duke u përcaktuar detyrat dhe përgjegjësit në mes të KRPP-së dhe KIPA;
- Vlefshmëria e certifikatës së prokurimit publik të jetë:
 - a. Për nivelin Themelor me afat prej tri vitesh;
 - b. Për nivelin e Avancuar me afat të përhershëm;
- Të definohen në mënyrë me të qartë rastet e revokimit të Certifikatës së Prokurimit.

- Të rregullohet me ligj mbështetja me e madhe për zyrtarët e prokurimit, duke i mbrojtur ata nga presionet me rastin e dhënies së kontratës;
- Të vazhdohet me monitorimin e njoftimeve PARA publikimit të njoftimit të kontratës;
- Neni 59, i cili parasheh përmirësimin e gabimeve aritmetikore, të ri-definohet duke caktuar përqindjen e lejuar të përmirësimit të gabimeve aritmetikore (p.sh: plus apo minus 2 % nga çmimi i ofertës)
- Në nenin 61 të përfshihet edhe një dispozitë për çmimet abnormalisht të larta, dhe jo vetëm në çmimin total por edhe për artikuj / pozicione.
- Në nenin 65 të përfshihen edhe rastet në Procedurë Përmbarimi;
- Të zvogëlohet sa është e mundur përdorimi i procedurave të negociuara, si dhe kontratave me vlera të vogla dhe minimale, duke shfrytëzuar marrëveshjet publike kornizë, si dhe prokurimet e centralizuara;
- Ngritja e vetëdijes mbi prokurimin publik në mesin e autoriteteve kontraktuese, operatorëve ekonomikë, institucioneve të prokurimit publik, si dhe publikut të gjerë;

7. RAPORTI FINANCIAR

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

- Raporti Financiar për Vitin 2014 -

Kodi i Organizatës Buxhetore: 230

Informatat kontaktuese:

Zyrtari Kryesor Administrativ Kryetar i KRPP-së z, Safet Hoxha,

Zyrtari Kryesor Financiar Ismet Abdullahu, 038/213-707

Data: 16.02.2015

1) Hyrje: (Ju lutem paraqitni në formë tekstuale një përmbledhje të zhvillimeve kryesore në buxhetin e

Buxheti i KRPP-së i ndar sipas Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës nr. 04/L-233 për vitin 2014, (duke mos llogaritur Huamarrjen në vlerë 1,075,885 € për projektin e e-prokurimit dhe Donacionet e BB në vlerë prej 68,330.00€ për projektin e Monitorimi i Performancës së Entiteteve dhe Stafit të Prokurimit dhe Caktimi i çmimeve mesatare për njësi për punë) është:

Ndarjet në buxhetin e KRPP-së sipas Ligjit për Buxhetin janë sipas kategorive ekonomike; Paga & mëditje 202,611€, mallra dhe shërbime 127,341 €, shpenzime komunale 20,200 € .

Buxheti përfundimtar në SIMFK duket kështu: Paga & Mëditje 202,611.00 € ose shprehur në përqindje prej 57.86 % e buxhetit përfundimtar, Mallra & shërbime 90,210.00 € ose shprehur në përqindje prej 36.37 % e buxhetit përfundimtar, dhe Shpenzimet komunale 3,200.00€ ose shprehur në përqindje prej 1.08 % e buxhetit përfundimtar (të financuara nga kod, 10) .

Realizimi i buxhetit të KRPP-së për vitin 2014 është në vlerë prej 264,904.57€ ose shprehur në përqindje prej 89.49 % e buxhetit përfundimtar (gjithnjë pa pjesëmarrjen e projektit të BB dhe Huamarrjes për e-prokurim).

Alokimi i fondeve është bërë në bazë të planit të rrjedhës së parës të përgatitur nga ZKF-ja në bashkëpunim me Menaxhmentin e KRPP-së.

Në këtë raport do të paraqiten në mënyrë të hollësishme shpenzimet e realizuara nga buxheti i KRPP-së për vitin 2014, si dhe krahasimi i tyre me periudhën e njëjte të vitit 2013.

organizatës suaj. Të mos kalohet hapësira e ofruar më poshtë!)

2) Përmbledhje për të hyrat dhe kategoritë e veçanta të shpenzimeve:

(Ju lutem paraqitni shkurtimisht ndryshimet kryesore për sa i përket vlerave të parashikuara dhe atyre aktuale për secilën kategori. Të mos kalohet hapësira e ofruar më poshtë)

a) Të hyrat:

KRPP-ja nuk gjeneron të hyra

b) Pagat dhe mëditjet:

(Ju lutem të bashkëngjitet organogrami i organizatës suaj si aneks i këtij raporti financiar dhe plotësoni tabelën shtesë lidhur me strukturën e pagesës në pikën 4 f) të këtij raporti)

) Pagat dhe meditet:

(Ju lutem, te bashkengjitet organogrami i organizates suaj si aneks i ke'tij raporti fmanciar dhe plotesoni tabelen shtese lidhur me strukturen e pageses ne pike'n 4 f) te ke'tij raporti).

Kategoria e Paga & meditje merr pjese ne buxhetin perfundimtar me 202,611€ ose me 57.86% ne buxhetin e KRPP- dhe si te tilla jane te ndara vetëm në nje Programe Buxhetor.

Shkalla e shpenzimit te buxhetit ne kete kategori ekonomike per vitin 2014 eshte 196,525€, shprehur ne perqindje 97.00 % e buxhetit ne kete katgori ose 74.19 % krahasuar me buxhetin e shpenzuar teKRPP-se

c) Mallra dhe Shërbime:

c) Mallra dhe shërbime:

Kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve merr pjesë në buxhetin përfundimtar me 90,210 € ose me 36.37% në buxhetin e KRPP- dhe si të tilla janë të ndara vetëm në një Program Buxhetor. Shkalla e shpenzimit të buxhetit në këtë kategori ekonomike për vitin 2014 është 65,782 €, shprehur në përqindje 72.92 % e buxhetit në këtë kategori ose 24.83 % krahasuar me buxhetin e shpenzuar të KRPP-se

Shpenzime në mallra dhe shërbime (, pagesat për ekspertin ndërkombëtar të TI në kodin ekonomik 13440 , prej 37,844.50€ dhe pagesat për sistemin e- prokurimit në kodin ekonomik 13440 në vlerë prej 64,113.50€).

d) Shpenzime komunale:

d) Shpenzime komunale:

Kategoria e shpenzimeve komunale merr pjesë në buxhetin përfundimtar me 3,200 € ose me 1.08% në buxhetin e Kuvendit

. Shkalla e shpenzimit të buxhetit në këtë kategori ekonomike për vitin 2014 është 2,597 €, shprehur në përqindje 81.16% e buxhetit në këtë kategori ose 0.98 % krahasuar me buxhetin e shpenzuar të KRPP-se

e) Investimet Kapitale:

f) Subvencionet dhe Transferet:

3) Përmbledhje:

(Ju lutem paraqitni shkurtimisht vërejtjet përfundimtare lidhur me buxhetin e institucionit tuaj apo pikëpamjet për zhvillimet në të ardhmen)

Në realizimin e bugjetit në nivelin e paraqitur prej 25.47%, në tabelat e më poshtme për vitin 2014 ndikim të madh ka pasur projekti i huamarrjes (e-prokurim) në vlera 1,075.885.00€ , pjesmarrja e huamarrjes në buxhetin e tërsishëm të KRPP-së ishte 75.45% i cili në vitin 2014 është realizuar vetëm prej 3.53% , pagesat për ekspertin nderkombtar të TI në kodin ekonomik (13440) , prej 37,844.50€ .

Në pasqyrat e pagesave në tabelat në vijim paraqitet edhe donacioni i BB për projektin Monitorimi i Performancës së Entiteteve dhe Stafit të Prokurimit dhe Caktimi i çmimeve mesatare për njësi për punë, mallra dhe shërbime në sistemin e prokurimit publik të Kosovës në kodin ekonomik (13440) në vler prej 64,113.50€

Nënshkrimi i Udhëheqësit të Organizatës

4) Tabelat:

a) Të hyrat:

(Ju lutem plotësoni tabelën me informatat e nevojshme. Mund të shtohen rreshta shtesë në tabelë)

[illegible]

b) Shpenzimet:

(Ju lutem plotësoni tabelën me të dhënat e nevojshme.)

Kodi Ekono mik	Kategoria Ekonomike	Buxheti dhe shpenzimet 2013			Buxheti vjetor me ligjin e buxhetit (2014)	Buxheti me rishikim 2014 (nëse ka pasur ndryshime)	Buxheti përfundimtar 2014	Shpenzimet deri më 31 dhjetor 2014	Zotimet deri më 31 dhjetor 2014	Buxheti i zotuar (në %)	Buxheti i shpenz ur (në %)
		Buxheti (2013)	Shpenzimet (2013)	% e shpenzi mit							
1	2	3			4	5	6	7	8	9	10
11000	Paga dhe Mëditje	179,859.00	168,673.48	93.78	202,611.00		202,611.00	196,525.19	196,525.19		97.00
13000	Mallra dhe Shërbime	127,306.00	109,410.28	85.94	1,203,226.00		1,234,425.00	167,740.42	167,740.42		8.89
13200	Shpenzime Komunale	12,200	9,466.45	77.59	20,200.00		3,200.00	2,596.96	2,596.96		81.16
21000	Subvencione dhe Transfere										
30000	Investimet Kapitale										
	Gjithsej	319.365.00	287,550.21	90.00	1,426,037.00		1,440,236.00	366,862.57	366,862.57		25.47

Mallra dhe Shërbime

4.c) DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

		Buxheti 2013			Buxheti 2014		
13000	MALLRA DHE SHËRBIME Emri i kategorisë ekonomike	Planifikimi (2013)	Shpenzimet (2013)	% e shpenzimit	Planifikimi (2014)	Shpenzimet në (2014)	% e shpenzimit
	Gjithsej Mallra dhe Shërbime	127,306.00	109,410.28	85.94	1,229,961.52	167,740.4	13.64

1310	SHPENZIMET E UDHËTIMIT (NENTOTALI)	9,500.00	7,227.06		15,000.00	8,988.00	59.92
13130	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit					5.00	
13131	Mëditja e udhëtimit zyrtar brenda vendit						
13132	Akomodimi gjate udhëtimit zyrtar brenda vendit						
13133	Shpenzimet tjera te udhëtimit zyrtar brenda vendit						
13140	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	9,50.000	7,227.06		15,000.00	8,125.00	
13141	Mëditja e udhëtimit zyrtar jashtë vendit						
13142	Akomodimi gjate udhëtimit zyrtar jashtë vendit					858.00	
13143	Shpenzimet tjera te udhëtimit zyrtar jashtë vendit						

1330	SHËRBIMET E TELEKOMUNIKIMIT (NENTOTALI)	12,500.00	12,360.00		13,200.00	11,822.00	89.56
13310	Shpenzimet për internet					2.00	
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile	12,500.00	12,360.00		13,200.00	11,820.00	
13330	Shpenzimet postare						
13340	Shpenzimet e përdorimit të kabllit optik						

1340	SHPENZIMET PER SHËRBIME (NENTOTALI)	16,500.00	15,626.41		1,106,226.00	104,219.90	9.42
13410	Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	2,000.00	3,429.00		1,200.00	989.90	
13420	Shërbimet e përfaqësimit dhe avokaturës						
13430	Shërbime të ndryshme shëndetësore						
13440	Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse				1,075,885.00	101,958.00	
13450	Shërbime shtypje- jo marketing	1,500.00	1,055.00		6,000.00	972.00	
13460	Shërbime Kontraktuese Tjera	13,000.00	11,142.41		12,341.00	300.00	
13470	Shërbime Teknike						
13480	Shpenzimet për Anëtarësim						

1350	BLERJE E MOBILJEVE DHE PAISJEVE (ME PAK SE 1000 EURO) (NENTOTALI)	5,000.00	16,109.54		7,000.00	8,824.65	126.06
13501	Mobile (me pak se 1000 euro)		2,664.00		5,000.00		
13502	Telefona (me pak se 1000 euro)		5,034.00			720.00	
13503	Kompjuterë (me pak se 1000 euro)	3,000.00	5,507.50			7,988.00	

13504	Harduer për teknologji informative (me pak se 1000 euro)						
13505	Makina fotokopjuese (me pak se 1000 euro)						
13506	Pajisje speciale mjekësore (me pak se 1000 euro)						
13507	Pajisje te shërbimit policor (me pak se 1000 euro)						
13508	Pajisje trafiku (me pak se 1000 euro)						
13509	Pajisje tjera (me pak se 1000 euro)	2,000.00	2,904.04		2,000.00	116.65	

1360	BLERJE TJERA - MALLRA DHE SHERBIME (NENTOTALI)	5,406.00	7,890.62		7,935.0	10,751.28	135.49
13610	Furnizime për zyrë	3,300.00	7,890.62		5,000.00	10,399.36	
13620	Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)					351.92	
13630	Furnizime mjekësore						
13640	Furnizime pastrimi	2,106.00			2,935.00		
13650	Furnizim me veshmbathje						
13660	Akomodimi						
13670	Municion dhe armë zjarri						
13680	Tiketatat siguruese(banderolat)						
13681	Bllombat						

1370	DERIVATET DHE LËNDËT DJEGËSE (NENTOTALI)	10,500.00	8,345.49		12,000.00	8,475.67	70.63
13710	Vaj						

13720	Nafte për ngrohje qendrore						
13730	Vaj për ngrohje						
13740	Mazut						
13750	Qymyr						
13760	Dru						
13770	Derivate për gjenerator	500.00			500.00		
13780	Karburant për vetura	10,000.00	8,345.49		11,500.00	8,475.67	

1380	LLOGARITE E AVANSIT (NENTOTALI)						
13810	Avans për para te imëta (p.cash)						
13820	Avans për udhëtime zyrtare						
13821	Avans						
13830	Avans për mallra dhe shërbime						
13850	Avanc për ambasadat						

1390	SHËRBIMET FINANCIARE (NENTOTALI)						
13911	Provizion Bankar-Banka Qendrore						
13912	Provizion Bankar-Raiffeisen Bank						
13913	Provizion Bankar-Procredit Banke						
13915	Provizion Bankar-Banka Private e Biznesit						
13916	Provizion Bankar-Banka Ekonomike						

13917	Provizion Bankar-NLB Banka Prishtina						
13918	Provizion për Tarifa të Ndryshme						
13940	KPA-Provizioni Bankar						

1395	SHERBIMET E REGJISTRIMIT DHE SIGURIMEVE (NENTOTALI)	3,000.00	2,346.01		3,500.00	1,929.91	55.11
13950	Regjistrimi i automjeteve						
13951	Sigurimi i automjeteve	3,000.00	2,346.01		3,500.00	1,929.91	
13952	Taksa komunale e regjistrimit te automjeteve						
13953	Sigurimi i ndërtesave dhe tjera						

1400	MIRËMBAJTJA (NENTOTALI)	13,000.00	6,791.63		18,000.00	9,116.92	50.64
14010	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	10,000.00	6,125.89		15,000.00	7,610.88	
14020	Mirëmbajtja e ndërtesave		665.74			150.00	
14021	Mirëmbajtja e ndërtesave te banimit						
14022	Mirëmbajtja e ndërtesave administrative afariste						
14023	Mirëmbajtja e shkollave						
14024	Mirëmbajtja e objekteve shëndetësore						
14030	Mirëmbajtja e auto rrugëve						
14031	Mirëmbajtja e auto rrugëve regjionale						
14032	Mirëmbajtja e auto rrugëve lokale						

14040	Mirëmbajtja e Teknologjisë Informative	2,000.00			2,000.00	1,356.04	
14050	Mirëmbajtja e mobileve dhe paisjeve	1,000.00			1,000.00		

1410	QIRAJA (NENTOTALI)	48,000.00	28,750.00		16,465.00		
14110	Qiraja për ndërtesa	48,000.00	28,750.00		16,465.00		
14120	Qiraja për toke						
14130	Qiraja për paisje						
14140	Qiraja për makineri						
14150	Qiraja për përdorime tjera hapësinore						

1420	SHPENZIMET E MARKETINGUT (NENTOTALI)	800.00	249.98		800.00	315.00	39.38
14210	Reklamat dhe konkurset						
14220	Botimet e publikimeve	800.00	249.98		800.00	315.00	
14230	Shpenzimet per informim publik						

1430	SHPENZIMET E PËRFAQËSIMIT (NENTOTALI)	3,100.00	3,897.55		3,100.00	3,291.45	106.18
14310	Drekat zyrtare	3,100.00	3,897.55		3,100.00	3,291.45	

1440	SHPENZIME-VENDIMET EGJYKATAVE (NENTOTALI)						
14410	Shpenzime-vendimet e gjykatave						

1700	SERVISIMI I BORGJIT (NENTOTALI)						
17000	Pagesa e borxhit qeveritar						

4.d). SHPENZIMET KOMUNALE

DETAJET SIPAS KODEVE EKONOMIKE

		Buxheti 2013			Buxheti 2014		
1320	Shpenzimet Komunale Emri i kategorisë ekonomike	Planifikimi (2013)	Shpenzimet (2013)	% e shpenzimit	Planifikimi (2014)	Shpenzimet (2014)	% e shpenzimit
	Gjithsej Shpenzime Komunale	20,200.00	9,466.45		20,200.00	2,596.96	12.86
1320	SHPENZIME KOMUNALE (NENTOTALI)	20,200.00	9,466.45		20,200.00	2,596.96	
13210	Rryma	8,000.00	5,801.94		8,000.00		
13220	Uji	1,000.00	549.69		1,000.00		
13230	Mbeturinat	1,200.00	429.40		1,200.00		
13240	Ngrohjaqendrore	4,000.00	87.70		4,000.00		
13250	Shpenzimettelefonike	6,000.00	2,597.72		6,000.00/	2,596.96	

4.e) INVESTIMET KAPITALE: DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

		Buxheti 2013			Buxheti 2014			
3000	INVESTIMET KAPITALE Emri i kategorisë ekonomike	Planifikimi (2013)	Shpenzimet (2013)	% e shpenzimit	Planifikimi (2014)	Shpenzimet (2014)	Zotimet deri 31.12.2014	% e shpenzi mit
Gjithsej Investimet Kapitale								

3110	NDËRTESTAT (NENTOTALI)							
31110	Ndërtesat e banimit							
31120	Ndërtesat administrative afariste							
31121	Objektet arsimore							
31122	Objektet shëndetësore							
31123	Objektet kulturore							
31124	Objektet sportive							

3120	NDËRTIMI I RRUGËVE (NENTOTALI)							
31210	Ndërtimi i auto rrugëve							
31220	Ndërtimi i rrugëve regjionale							
31230	Ndërtimi i rrugëve lokale							
31240	Trotuaret							
31250	Kanalizimi							

31260	Ujësjetllësi							
-------	--------------	--	--	--	--	--	--	--

3150	FURNIZIM ME RRYMË, GJENERIMI (NENTOTALI)							
31510	Furnizim me rrymë gjenerim dhe transmision							

3160	PAISJE (SIST.VLERA MBI 1000 EURO) (NENTOTALI)							
31600	Pajisje të Teknologjisë Informative(ne vlere mbi 1000 euro)							
31610	Pajisje të Teknologjisë Informative							
31620	Mobilje							
31630	Telefona							
31640	Kompjuter							
31650	Makina Fotokopjuese							
31660	Pajisje Speciale Mjekësore							
31670	Pajisje te Shërbimeve Policore							
31680	Souftver							
31690	Pajisje Tjera							

3170	AUTOMJETE TRANSPORTI (NENTOTALI)							
31700	Vetura zyrtare							
31701	Kamionë							
31702	Xhip dhe kombibusë							

31703	Vetura të ndihmës së shpejtë							
31704	Veturat e shërbimit policor							
31705	Motorë							
31706	Automjete transporti tjera							

3180	MAKINERIA (NENTOTALI)							
31800	Makineria							

3190	KAPITAL TJETËR (NENTOTALI)							
31900	Kapital tjetër							
31910	Avans për investime							

3210	TOKA (NENTOTALI)							
32100	Toka							

3220	PASURITË E PAPREKSHME (NENTOTALI)							
32200	Pasuri e paprekshme							

3310	TRANSF.KAPITALE-ENTITETE (NENTOTALI)							
33100	Trans.kap.-entitetet publike							

4.f) SUBVENCIONET DHE TRANSFERET: DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

		Buxheti 2013			Buxheti 2014		
21000	Subvencione dhe Transfere Emri i kategorisë ekonomike	Planifikimi (2013)	Shpenzimet (2013)	% e shpenzimit	Planifikimi (2014)	Shpenzimet (2014)	% e shpenzimit
Gjithsej subvencione dhe transfere							

2100	SUBVENCIONET						
21110	Subvencionet për Etnitete Publike						
21120	Subvencionet për Etnitete Publike						
21200	Subvencionet për Etnitete Jopublike						

2200	TRANSFERET						
22100	Transfere për qeveri tjera						
22110	Unops-projekti i administratës- Agjensioni Kosovar I Pronave						
22200	Pagesat për përfitues individual						
22210	Pensionet bazë						
22220	Pensionet për persona me aftësi të kufizuar						
22230	Pensionet e ndihmës sociale						
22235	Pensionet e TMK-së						
22240	Pensionet-Kategoria I						
22250	Pensionet-Kategoria II						

22260	Pagesat për Invalidët e luftës						
22270	Pagesat për invalidët civilë						
22280	Pagesat e familjeve të të rënëve ne luftë						
22300	Pagesa-vendime gjyqësore						

4. f) Personeli dhe struktura e pagave në vitin 2014:

(Ju lutem plotësoni tabelën me të dhënat e nevojshme dhe të bashkëngjitet organogrami i institucionit tuaj me këtë raport financiar)

Niveli	Pozitat e aprovuara me Ligjin për Buxhet	Pozitat e plotësuara	Buxheti i aprovuar aprovuara me Ligjin e Buxhetit për Paga dhe mëditje	Buxheti i shpenzuar për paga deri me 31 dhjetor 2014	Totali i pagesave shtesë	Numri i përgjithshëm i të punësuarve që pranojnë pagesa shtesë	a) Orari i punës (orar i plotë/gjysëm orari) dhe b) Të specifikohet lloji i pagesës shtesë
1	2	3	4	5	6	7	8
Niveli i Bordit	3	3					
Niveli i menaxhmentit të lartë							
Niveli i menaxhmentit	6	6					
Niveli profesional	20	16					
Niveli mbështetës	4	4					
Totali	33	29	202,611.00	196,925.19	9,600.00	4	3,pun,TI,dhe shoferi

Ju lutem bashkangjitni Organogramin (strukturën organizative) të organizatës tuaj.

8. RAPORTIMI RRETH ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr.	Rekomandimet	Përbushja e Rekomandimeve	Data e planifikuar për përbushje	Efekti
1	Rekomandimi 1 Kryetari duhet të përcaktojë se pse këshilla e ZAP-it për të prezantuar saktë donacionet e pranuar nuk ishte adresuar nga stafi i financave dhe të sigurojë që plani për përgatitjen e PVF-ve të vitit 2014 përfshin shqyrtim të mjaftueshëm menaxherial për të siguruar se janë adresuar që të gjitha udhëzimet/kërkesat e kontabilitetit.	I përbushur menjëher.	01.01.2014	
2	Rekomandimi 2 Kryetari duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.	I përbushur	01.06.2014	
3	Rekomandimi 3 Kryetari duhet të sigurojë që tarifat e shpenzimeve të telefonisë mobile të jenë në përputhje me tarifat e përcaktuara me UA.	KRPP-ja këtë rekomandim do ta harmonizoj me UA.04/2008 .	30.12.2014	

4	Rekomandimi 4 Kryetari duhet të siguroj regjistrimin e menjëhershëm të të gjithë pasurisë së KRPP-së në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të ri Administrativ nr. 02/2013 dhe që zyrtari i pasurive është duke e kryer punën e tij në mënyrë të përgjegjshme.	Rekomandim i përmbushur menjëher .	01.01.32014	
5	Rekomandimi 5 Kryetari duhet të siguroj që në një periudhë sa më të shkurtër të bëhet implementimi i plotë i sistemit të “e-Pasurisë”.	KRPP-sistemin e-Pasuri do ta aplikoj menjëherë pas hudhjes te dhanave nga prodhuesit e programit në sistem.	Proces	
6	Rekomandimi 6 Kryetari të siguroj se janë marrë masat e nevojshme që procesi i auditimit të brendshëm për vitin aktual do të realizohet.	Për këtë rekomandim KRPP-ka siguruar auditimin e brendshëm dhe është përfshi në planin e AB të MF-it për vitin 2014.	01.01.2014	

9. SHTOJCAT

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik në pajtim me Nenin 87, paragrafin 2, nën paragrafin 2.6 të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, adopton këtë:

Udhëzim Administrativ Nr. 1/2014 **Për përgatitjen e specifikimeve teknike për Kontratat për Punë**

Neni 1 **Qëllimi**

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativë është që të ofron udhëzime për Autoritetin Kontraktues në përgatitjen e Specifikave Teknike për kontratat e punës, në pajtueshmëri me Nenin 27.1 (Dosja e Tenderit) dhe 28 (Specifikat Teknike) të Ligjit mbi Prokurimin Publik Nr 04/L-042.

Neni 2 **Termat e përdorura**

Termat e përdorura në këtë Udhëzim Administrativë kanë të njëjtin kuptim siç përmendën në Nenin 4 (Përkufizimet) të Ligjit mbi Prokurimin Publik Nr 04/L-042.

Neni 3 **Përmbajtja e Specifikave Teknike për kontratat e punës**

Specifikat Teknike për kontratat e punës duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performances të punëve të kërkuara. Specifikat Teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutiv që duhet të përpilohet në pajtim me Nenin 4 të këtij Udhëzimi.

Specifikat Teknike për kontratat e punës duhet të përgatiten në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin specifik që është në fuqi në Republikën e Kosovës si dhe, në raste kur kërkohet, rregullave të përcaktuara në certifikatat administrative dhe lejet e nevojshme për punimet që do të ekzekutohen.

Neni 28 i Ligjit mbi Prokurimin Publik Nr 04/L-042, Specifikat Teknike për kontratat e punës duhet të tregoj, ku është e aplikueshme:

- a) reference për aktet e legjislacionit kombëtar të cilat duhet të jenë në pajtueshmëri me certifikatat dhe autorizimet administrative për ekzekutimin e punimeve siç kërkohet me aktet legjislative, ose , alternativave , përjashtimet dhe devijimet e lejuara.
- b) një përshkrim i përgjithësuar i vendndodhjes dhe/ose ndërtesës (lokacioni, madhësia, sasia e pjesëve të ndërtesës, elementet strukturore, instalimet ekzistuese, etj) dhe synimi i fushëveprimit të vendndodhjes/ndërtesës.
- c) fushëveprimi i veprimtarive punuese (ndërtimi i një objekti të ri, rindërtimi, zgjerim, demolim, modernizim, ristrukturim etj) si dhe një përshkrim i detajuar për zgjidhjet teknike që synohen, duke ju referuar Projektit Ekzekutiv në atë mënyrë që lejon identifikimin e tyre;
- d) një përshkrim i detajuar i teknikave ndërtuese, pajisjet dhe materialet që do të përdoren, me një indikacion për alternativat e mundshme dhe zgjidhje ekuivalente teknike, duke ju referuar Projektit Ekzekutiv në atë mënyrë që lejon identifikimin e tyre;
- e) standardet ambiente dhe shoqërore;

- f) kriteri i qasjes për njerëz me aftësi të kufizuara;
- g) nivelet e cilësisë dhe procedurat që lidhen me sigurimin e cilësisë të përcaktuar;
- h) testimi, inspektimi dhe pranimi i kushteve për punët dhe metodat ose teknikat e ndërtimit si dhe të gjitha kushtet tjera teknike të cilat mund të kërkojë Autoriteti Kontraktues duke u bazuar në rregullat e përgjithshme ose specifike në lidhje me punët e përfunduara si dhe materialet ose pjesët përbërëse;
- i) kushtet për instalim, mirëmbajtje dhe shërbimet/punët pas shitjes;
- j) siguria në punë dhe masat e sigurisë, duke përfshirë terminologjinë, simbolet, metodat testuese dhe plani i tyre implementues;
- k) data e fillimit dhe data e përfundimit të punimeve;
- l) indikacion në lidhje me shumën e kostos (çmimi njësi / çmimi total)
- m) çfarëdo rrethane tjetër specifike që në mënyrë substanciale mund të ketë ndikim në ekzekutimin e punimeve.

Duke marrë parasysh kompleksitetin e disa kontratave të punës, përgatitja e Specifikave Teknike, do të mund të ketë nevojë për asistencë nga një ose më shumë specialist teknikë të jashtëm. Në kësi rastesh, autoritetet kontraktuese duhet të kërkojnë nga specialistet e selektuar që të nënshkruajnë Deklaratën e Objektivitetit dhe Konfidencialitetit.

Neni 4 **Projekti Ekzekutiv**

Projekti Ekzekutiv është një dizajn grafik i të gjitha proceseve administrative dhe inxhinjerike të punimeve të kërkuara siç është përshkruar në Specifikat Teknike dhe prandaj , parashtrohet, në raste të veçanta, punime arkitektonike, strukturore të punëve që do të ekzekutohen.

Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutiv dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Projekti Ekzekutiv duhet të përfshin, ku është e mundur, si në vijim:

- a) Planin apo planet e lokacionit, që do të përfshijë një përfaqësim grafik të vendit ku do të bëhet ndërtimi, ndërtesat ekzistuese, të mbetura apo të planifikuara, ndërtesat e demoluara, vegjetacionin, si dhe masat përcaktuese si një skicë e lidhjeve në mes të vendit dhe / ose ndërtesat dhe të rrjetit të energjisë dhe lidhjen me sistemin publik të shërbimeve të saj,
- b) Planet gjenerale dhe planet e kateve, seksionet vertikale dhe horizontale, seksionet gjatësore, seksionet kryqezuese, pamjet, etj, në baze të të cilave, ndërtesa dhe pjesët e saj , lokacioni hapësinor, masat, strukturat, materialet, instalimet, etj, mund të përcaktohen sasia, mund të kontrollohet si dhe planet implementuese mund të përgatiten,

Neni 5



Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik në pajtim me Nenin 87, paragrafin 2, nën paragrafin 2.9 dhe nenin 91 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, nxjerrë këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 02/2014

Për Sigurinë e Tenderit, Sigurimin e Ekzekutimit dhe Aplikimin e kriterit përzgjedhës ekonomik dhe financiar.

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është që të ofrojë sqarime për Autoritetet Kontraktuese në zbatimin e Nenit 57 (Sigurimi i Tenderit) dhe 63 (Siguria e Ekzekutimit) të Ligjit mbi Prokurimin Publik Nr 04/L-042. Për më tepër, për t'ju ofruar Autoriteteve Kontraktuese sqarime në aplikimin e kriterit përzgjedhës, me theks të veçantë të Nenit 68 (Gjendja ekonomike dhe financiare) e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik.

Neni 2 Termat e përdorur

Termat e përdorur në këtë Udhëzim Administrativ kanë të njëjtin kuptim siç përmendën në Nenin 4 (Përkufizimet) të Ligjit Nr 04/L-042 për Prokurimin Publik.

Neni 3 Formulari i Sigurimit të Tenderit

1. Sipas dispozitave të përbashkëta në fuqi nenit 57, paragrafi 5 të LPP, dhe nenit 26, paragrafi 5 të Udhëzuesit për Prokurimin Publik të miratuar nga KRPP-ja, sigurimet e tenderit mund të ofrohen nga tenderuesit sipas gjykimit të tyre të vetëm, ekskluzivisht në njërin nga format e mëposhtme:
 - në para të gatshme ose të barasvlershëm, siç është transferi bankarë;
 - çek i certifikuar nga një bankë me reputacion;
 - letër krediti të pakushtëzuar të hapur dhe të konfirmuar nga një bankë me reputacion;
 - bono të përformancës, të zbatueshme me kërkesë, të lëshuar nga një kompani e sigurimeve me reputacion
 - garanci Bankare të pakushtëzuar të lëshuar nga një bankë me reputacion.
2. Për qëllimet e paragrafit paraprak:
 - (i) **një bankë “me reputacion”** nënkupton një bankë që ka klasifikim afat-gjatë të paktën “A” sipas një ose më shumë agjencive të vlerësimit ose në rast të një banke në Kosovë (nëse banka nuk është e vlerësuar në atë formë) një bankë që është e licencuar nga Autoriteti Qendror Bankarë në Kosovë.
 - (ii) **një kompani e sigurimeve “me reputacion”** nënkupton një kompani të sigurimeve që ka klasifikim afat-gjatë të paktën “A” sipas një ose më shumë agjencive të vlerësimit ose në rast të një kompanie të sigurimeve në Kosovë

(nëse kompania e sigurimeve nuk është e vlerësuar në atë formë) një kompani të sigurimeve që është e licencuar nga Autoriteti Qendror Bankarë në Kosovë.

3. Në pajtim me paragrafin 2, autoritetet kontraktuese nuk do të kufizojnë në dokumentet e tenderit diskrecionin e tenderuesve që të paraqesin sigurimin e tenderit në cilëndo nga format e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni. Çdo dispozitë që kufizon formën në të cilën sigurimet e tilla mund të dorëzohen përveç atyre të referuara në paragrafin 1, do të konsiderohet e pavlefshme.

Neni 4

Formulari i Sigurimit të Ekzekutimit

1. Sipas dispozitave të përbashkëta në fuqi nenit 63, paragrafi 5 të LPP dhe nenit 27, paragrafi 5 të Udhëzuesit për Prokurimin Publik të miratuar nga KRPP-ja, sigurimet e ekzekutimit mund të lëshohen nga operatori ekonomik i cili është shpërblyer me kontratë, sipas gjykimit të tij të vetëm, ekskluzivisht në njërin nga format e mëposhtme:
 - në para të gatshme ose të barasvlershëm, siç është transferi bankarë;
 - çek i certifikuar nga një bankë me reputacion;
 - letër krediti të pakushtëzuar të hapur dhe të konfirmuar nga një bankë me reputacion;
 - bono të përformancës, të zbatueshme me kërkesë, të lëshuar nga një kompani e sigurimeve me reputacion
 - garanci Bankare të pakushtëzuar të lëshuar nga një bankë me reputacion.
2. Për qëllimet e paragrafit paraprak një “bankë me reputacion” dhe një “kompani e sigurimeve me reputacion” kanë të njëjtin kuptim me atë të dhënë në nenin 3, paragrafi 2.
3. Në pajtim me paragrafin 2, autoritetet kontraktuese nuk do të kufizojnë në dokumentet e tenderit diskrecionin e operatoreve ekonomik që të paraqesin sigurimet e ekzekutimit në cilëndo nga format e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni. Çdo dispozitë që kufizon formën në të cilën sigurimet e tilla mund të dorëzohen përveç atyre të referuara në paragrafin 1, do të konsiderohet e pavlefshme.

Neni 5

Gjendja ekonomike dhe financiare

1. Sipas nenit 68 të LPP, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga tenderuesit plotësimin e kërkesave minimale ekonomike dhe financiare si kriter për përzgjedhje për pjesëmarrje në një procedurë tenderuese. Qëllimi i këtij kriteri është që të vlerësojë nëse tenderuesi ka stabilitet të mjaftueshëm ekonomik dhe financiar për të përformuar kontratën e propozuar.

Kerkesat e tilla minimale nuk i referohen detyrimisht:

- qarkullimet globale, duke përfshirë këtu një qarkullim minimal eventual në një fushë specifike në kuadër të kontratës;
 - llogaritë vjetore, duke përfshirë informacione në lidhje me asetet dhe detyrimet aktuale;
 - burimet financiare në dispozicion;
2. Autoritetet kontraktuese do të kufizojnë kërkesat duke lënë vetëm ato që janë të përshtatshme për të siguruar që tenderuesi ka sigurinë e nevojshme ekonomike dhe financiare për të përformuar kontratën e dhënë. Të gjitha kërkesat do të jenë strikt të lidhura dhe proporcionale me temën e kontratës në mënyrë që të sigurojnë një garë të drejtë dhe të singhtë.
3. Në përcaktimin e qarkullimit minimal, autoritetet kontraktuese nuk duhet të kalojnë dy herë vlerën e parashikuar të kontratës, përveç në raste të justifikuara siç bëjnë ndaj rreziqeve të veçanta që lidhen me natyrën e punëve, shërbimeve ose furnizimeve të ofruara. Autoriteti kontraktues do t'i specifikojë rrethanat e tilla të jashtëzakonshme në dokumentet e tenderit. Kërkesat për qarkullim duhet të shprehen detyrimisht në shifra dhe do t'i referohen maksimum tri viteve të fundit financiare të përfunduara nga data e publikimit të njoftimit të kontratës. Vitet e tilla financiare do të tregohen shprehimisht në Njoftimin e Kontratës ose në Ftesën për Tender ose Pjesëmarrje.
4. Kur, përveç qarkullimit minimal, një qarkullim i caktuar minimal në fushat specifike të mbuluara nga kontrata është i nevojshëm, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë 1.50 herë vlerën e parashikuar të kontratës. Të gjitha dispozitat tjera të referuara në paragrafin 3 dhe 5 të këtij neni zbatohen edhe në këtë rast.
5. Përsa i përket paragrafit 3 dhe 4 të këtij neni, autoritetet kontraktuese do të shprehin në Njoftimin e Kontratës kushtin për kualifikim, duke përzgjedhur në mesin e njërit prej kritereve vijuese:
- 1) xhiroja **totale** e tenderuesit në tri vitet e fundit financiare duhet të kalojë (ose të jetë i barabartë) me qarkullimin minimal siç tregohet në Njoftimin e Kontratës.
- 2) Qarkullimi **mesatar** i tenderuesit në tri vitet e fundit financiare duhet të tejkalojë (ose të jetë e barabartë), për secilin prej këtyre viteve financiare, kërkesës minimale për qarkullim siç tregohet në Njoftimin e Kontratës
- 3) vetëm kur kontrata ka një kohëzgjatje më të gjatë se një vit, qarkullimi mesatar i tenderuesit gjatë tri viteve të kaluara financiare duhet të kalojë (ose të jetë e barabartë), për secilin prej këtyre viteve financiare, kërkesa minimale vjetore për qarkullim përcaktohet sipas formulave të mëposhtme matematikore: $Vlera\ e\ kontratës / numri\ i\ viteve \times 2$ ose $vlerës\ së\ kontratës / numri\ i\ muajve \times 12 \times 2$.

Në rast të dorëzimit të tenderit nga një grup, formulat e mësipërme për përshtatshmëri do të aplikohet edhe te grupi si një njësi.

6. Pavarësisht nga paragrafi 2 i këtij neni, autoritetet kontraktuese do të specifikojnë në Njoftimin e Kontratës se cilin nga kriteret që përmenden në paragrafin e mësipërm do të aplikojnë. Zgjedhja do të bëhet nën diskrecion të autoriteteve kontraktuese në mënyrë jo-diskriminuese, dhe në çdo rast duke marrë parasysh qëllimin e kontratës, rreziqet në lidhje me zbatimin e kontratës dhe vetë kushtet specifike të tregut specifik në mënyrë që të mos e kufizojë konkurrencën.
7. Kur kontrata është e ndarë në lote, neni aktual do të zbatohet në secilin lot individualisht. Megjithatë, autoritetet kontraktuese mund të vendosin xhiro minimale që tenderuesit duhet të kenë duke iu referuar grupeve në lote në rast se ofertuesit të suksesshëm i janë dhënë disa lote për tu kryer në të njëjtën kohë.
8. Kur kontratat e bazuara në kontratë kornizë duhet të jepen sipas procedurës për rihapje të konkurrencës, kërkesat maksimale për qarkullim do të llogariten mbi bazën e vlerës së pritshme maksimale të kontratave të veçanta që do të jepen, ose, ku kjo nuk dihet, në bazë të vlerës së parashikuar të marrëveshjes kornizë.
9. Sipas nenit 68 paragrafi 2 të LPP-së, autoritetet kontraktuese do të specifikojnë kërkesat minimale ekonomike dhe financiare në Njoftimin për Kontratë ose në Ftesën për Tender ose Pjesëmarrje. Për më tepër autoritetet kontraktuese do të specifikojnë qartë në dokumentet e lartpërmendura, për çdo kërkesë ekonomike dhe financiare, referencat e përshtatshme në mesin e atyre të parashikuara në nenin 68, paragrafi 1, nënparagrafët 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të LPP-së.
10. Deklaratat e nevojshme sipas nenit 68, paragrafi 1, alineja 1.1, e LPP-së do të lëshohen nga bankat e klasit të parë.
11. Polica e sigurimit, sipas nenit 68, paragrafi 1, alineja 1.2, e LPP-së, do të lëshohet nga një kompani e njohur e licencuar e sigurimeve.
12. Për qëllimet e paragrafit paraprak një “një bankë e klasit të parë” dhe një “kompani e njohur e licencuar e sigurimeve” kanë të njëjtin kuptim të dhënë në nenin 3, paragrafi 2.

Neni 6

KRPP-ja është duke përgatitur një Udhëzues në mënyrë që të sqarojë më tej me shembuj aplikimin e rregullave që i referohen Nenit 4 të Udhëzimit Administrativ aktual.

Neni 7

Hyrja në fuqi



Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik në pajtim me Nenin 87, paragrafin 2, nën paragrafin 2.9 të Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, nxjerrë këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 03/2014

Për Disponueshmërinë e mjeteve për udhëheqje të aktiviteteve të prokurimit

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është që të ofrojë sqarime për Autoritetet Kontraktuese në zbatimin e Nenit 9 (Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur) të Ligjit mbi Prokurimin Publik (LPP) Nr 04/L-042.

Neni 2 Termet e përdoruar

Termet e përdorur në këtë Udhëzim Administrativ kanë të njëjtin kuptim siç përmendën në Nenin 4 (Përkufizimet) të LPP.

Neni 3 Disponueshmëria e fondeve

1. Në pajtim me nenin 36 dhe 37 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nr. 03/L-221 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-048, Ligjit Nr. 04/L-116 për Ndryshim dhe plotësim të Ligjit Nr. 04?-194 Për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03?L-048 të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr. 03/L221 dhe Nr. 04/L-116 dhe nenit 12 të Rregullores Financiare, nr. 01/2013, Autoritetet Kontraktuese, para se të fillone ndonjë aktivitet të prokurimit, duhet detyrimisht të sigurojnë që zotimi për alokimin e fondeve të nevojshme për prokurimin në fjalë është lëshuar dhe është regjistruar në SIMFK për të përmbushur, për secilin vit fiskal që i referohet prokurimit, detyrimet financiare që rrjedhin nga nënshkrimi i kontratës përkatëse.
2. Fondet do të alokohen dhe do të vihen në dispozicion në përputhje me kushtet e përbashkëta të parashikuara në nenin 9, paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të LPP, dhe në nenin 7 të Udhëzimit Operativ për Prokurimin Publik, miratuar nga KRPP-ja në pajtim me nenin 91, paragrafi 1, i LPP.
3. Duke iu nënshtruar të njëjtave kushteve të parashikuara në nenin 41 të LPP, dhe pa rënë ndesh me nenin 7.8 të Udhëzimit Operativ për Prokurimin Publik, Autoritetet Kontraktuese të cilat kanë shpërblyer një kontratë publike do të dërgojnë në KRPP, së bashku me njoftimin për dhënien e kontratës, një kopje të Deklaratës së Nevojave dhe Disponueshmërise së Mjeteve për kontratën e shpërblyer. Deklarata e sipërpërmendur do të hartohet në përputhje me formularin standard të miratuar nga KRPP-ja në pajtim me nenin 9, paragrafin 5, të LPP. Deklarata e tillë do të plotësohen në çdo pjesë dhe do të nënshkruhet nga ZKF në fjalë.

4. KRPP-ja do të vazhdojë me publikimin e njoftimit për dhënie të kontratës në përputhje me Nenin 42 të LPP me kusht që Deklarata e Nevojave dhe Disponueshmerise se Mjeteve është dërguar dhe i plotëson kushtet e referuara në paragrafin 3 të këtij neni.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi me 08 Janar 2014

08 01 2014

(Data e nënshkrimit)



[Handwritten signature]

Safet Hoxha – Kryetar i KRPP-së